# DËSHMI ARKIVI

**A-469294**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj korrupsionit, dikur lufta mungonte |
| ADRESA | `https://albeu.com/lajme/rama-ne-nju-jork-shqiperia-po-krijon-imunitet-ndaj-korrupsionit-dikur-lufta-mungonte/1027384/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 14:54:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 14:49:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f1d68da54e4b40adb73dfab4d3f1ac7f87dca580e2446d1dafffa3ab07486518` |
| TEKSTI | `0043ab0c384561cce226b39d7a59ef5df439b5212a4796ecee830069bf4e63d0` |
| PAMJA | `b627f79a510fe33dda371c290e1e723ab5479ac50f6194127bd80ade098c57a4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `af730ce6b9790e6c90872e9ea53ddedb4e243f12d203a61c80508a8a1da1d277` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/af730ce6b9790e6c90872e9ea53ddedb4e243f12d203a61c80508a8a1da1d277`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj korrupsionit, dikur lufta mungonte



Kryeministri Edi Rama tha në Nju Jork se vendi ka ndryshuar ndjeshëm në vitet e fundit. Ai përmendi rritjen ekonomike, investimet në infrastrukturë dhe institucionet që, sipas tij, janë forcuar në përballjen me korrupsionin.

Duke folur në mbrëmjen gala të Këshillit të Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane, Rama deklaroi se Shqipëria ka arritur rezultate që nuk pranohen lehtësisht nga të gjithë.

"Shqipëria ka ndryshuar shumë gjatë këtyre viteve. Suksesi nuk të falet. Prej pesë apo gjashtë vitesh kemi aeroportin më të madh në rajon. Ai është jo vetëm më i madhi në terma relativë dhe aeroporti me rritjen më të shpejtë në Europë, por edhe në shifra absolute, me më shumë udhëtarë se aeroporti i Beogradit. Rritja do të vijojë, sepse ky është vetëm fillimi," u shpreh ai.

Rama foli gjithashtu për mënyrën si perceptohet korrupsioni në Shqipëri. Ai tha se partnerët europianë e shohin si arritje faktin që institucionet po luftojnë çdo ditë këtë fenomen.

"Ajo që ne shqiptarët e konsiderojmë problem, partnerët tanë europianë e shohin si sukses. A mund të ketë më shumë korrupsion në një vend kur ai luftohet përditë? Dikur në Shqipëri korrupsioni ishte kudo, ndërsa lufta kundër tij nuk bëhej askund. Sot situata është ndryshe. Sistemi ynë demokratik ka nisur të krijojë imunitetin e vet," tha kryeministri.

Sipas tij, pavarësia e pushteteve, edhe pse shoqërohet me vështirësi dhe mangësi, dëshmon se korrupsioni nuk kalon më pa u ndëshkuar.

Kreu i qeverisë përmendi edhe përparimin në mbrojtjen e mjedisit, duke vënë në dukje ndalimin e gjuetisë dhe zgjerimin e territoreve të mbrojtura.

"Ky është një sukses i madh për një vend ku, dhjetë vjet më parë, mijëra gjuetarë europianë masakronin kafshë dhe shpendë. Sot në Shqipëri protestohet për biodiversitetin. Ndalëm gjuetinë, zgjeruam zonat e mbrojtura dhe

të fundit/


Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj…


Tre të plagosur pas përplasjes së dy makinave në aksin…


Acibadem Sistina realizon dy ndërhyrje gjinekologjike robotik…


GM përgatit motorin e ri V8 me naftë, me 555 kuaj/fuqi


Organizatat kosovare i kërkojnë Amnesty International të…


PD propozon ndarjen e re territoriale: 100 bashki dhe 12 qarqe


Oltjon Muzaka largohet nga Shëndetësia dhe emërohet zv.ministër …

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

ndaluam shfrytëzimin e pyjeve. Si rezultat, numri i shpendëve dhe kafshëve u trefishua, ashtu si edhe sipërfaqja e pyjeve të rikuperuara," deklaroi Rama.

Në fund, kryeministri vuri në dukje se pritshmëritë e qytetarëve për Shqipërinë janë rritur.

"Tani kemi një Shqipëri të re dhe njerëzit kërkojnë më shumë. Nuk ekziston më Shqipëria ku njerëzit mendonin se vendi mund të përfundonte edhe më keq," përfundoi ai.

Shtuar më 25.09.2026 16:49

Tags: edi rama , New York , Politike , vendi


Tre të plagosur pas përplasjes së dy makinave në aksin Elbasan-Peqin


Oltjon Muzaka largohet nga Shëndetësia dhe emërohet zv.ministër i Punëve të…


Mbërrin në Shqipëri ambasadori i ri i SHBA, Eric Wendt i dorëzon nesër…


Këshilli Bashkiak i Tiranës fton Erion Veliajn në mbledhje, kërkesë SPAK-…


Bardhi kërkon llogari nga Begaj për dekretimin e Vlora Hysenit: Shqiptarët…


"Bleona është gjallë"/ Mbesa e zhdukur prej 16 vitesh, flet gjyshi Zenel…


Aksident në autostradën Rrogozhinë-Lushnje/ Lëndohet çifti i…


Rama nga New Yorku në takimin e Këshillit Europian të Korporatave: Paqja,…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko



© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.